



PAKO E RIMËKËMBJES EKONOMIKE RAPORT PËRMBLEDHËS I DRITAREVE GARANTUESE NGA FKGK





Të dhënat në raport janë sipas raportimit të bërë deri më 20.01.2022.

Çdo përditësim i tyre mund të ndryshojë ndonjë informatë!

PËRMBAJTJA

04 I - HYRJE

05 II - IMPLEMENTIMI I PROGRAMIT

- 05 ASPEKTI LIGJOR
 - 06 KAPITALI
 - 06 PËRGADITJET OPERACIONALE
 - 07 KOMUNIKIMI
-

08 III - TË ARRITURAT

- 08 ZHVILLIMI I PORTOFOLIT TË DRITAREVE TË PRE-SË
 - 09 GARANCITË KREDITORE SIPAS DRITAREVE GARANTUESE
 - 09 PJESEMARRJA E KREDIVE TË GARANTUARA SIPAS INVESTIMIT
-

10 IV - SHTUESHMËRIA

- 10 PJESEMARRJA E KREDIVE TË GARANTUARA NË SEKTORIN BANKAR
 - 11 SHUMA MESATARE E KREDIVE TË GARANTUARA
 - 11 MESATARJA E MATURITETIT TË KREDISË
 - 12 MBULUESHMËRIA ME KOLATERAL
 - 12 NUMRI I PARASHIKUAR I VENDEVE TË KRIJUARA TË PUNËS
 - 13 PËRSHTYPJET NGA SEKTORI FINANCIAR
-

14 V - STORIE SUKSESI NGA PËRFITUESIT PËRFUNDIMTARË

- 14 "THE WHITE TREE" – Një start up në lagjen Pejton
 - 15 MOEA – FRUTOMANIA - Shishe e vogël me dashuri të madhe!
 - 16 AGRIMUM FRUITS SHPK - Storje e veçantë suksesi
 - 17 NATYRA G - Shtëpia e djathit
-

I. HYRJJE

Si në çdo vend në botë, edhe në vendin tonë pandemia COVID-19 ndikoi negativisht në rënie të likuiditetit të Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) pothuajse në të gjithë sektorët ekonomikë pa përjashtim. Natyrisht, kjo së pari preku aktivitetet që për shkak të pandemisë u detyruan të punonin me kapacitet të zvogëluar, ose të mbyllen fare.

Si përgjigje ndaj situatës pandemike nga COVID-19, e në mënyrë që të përballej me këtë situatë të pazakontë, Qeveria e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2020 ndërmori një sërë veprimesh të koordinuara, njëri ndër të cilat ishte dizajnimi i Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike. Pjesë e grupit punues ishin Zyra e Kryeministrit, ministritë relevante ekonomike, Banka Qendrore, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, komuniteti i biznesit, si dhe ekspertë të jashtëm.

Skemat e garancisë kreditore janë instrument ose dorë e zgjatur e politikës ekonomike të një shteti, përmes të cilave, duke ndarë një pjesë të riskut kreditor me bankat komerciale, mund të ndikohet në kthimin e konfidencës te sektori bankar për të katalizuar kreditimin, shumë të dëshiruar në ditët e para pas krizës. Me të drejtë, të gjitha pakot financiare të shteteve të ndryshme, apo institucioneve financiare ndërkombëtare, në mekanizmat e tyre për të luftuar krizën aktuale COVID-19, si nënkomponentë kanë paraparë krijimin e skemave të reja ose fuqizimin e skemave garantuese ekzistuese, me qëllim të stimulimit të kreditimit në ekonomi.

Fatmirësisht, në një situatë të krijuar nga pandemia COVID-19, vendi ynë kishte një institucion të themeluar enkas për ofrimin e skemave garantuese, të krijuar pesë vite më parë, prandaj ajo që nevojitej tani ishte adaptimi i skemës garantuese të FKGK-së me realitetin e ri, të krijuar nga kriza e pandemisë, me qëllim të lehtësimit të qasjes në financa për sektorët e caktuar të ekonomisë, e me theks të veçantë te segmentet e tregut që do të mund të ndikoheshin më shumë nga kriza e pandemisë.

Ky adaptim ishte një ndër masat më të rëndësishme të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike.

Në dhjetor të 2020-ës, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Ligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike – COVID-19. Në mesin e objektivave të tjerë, kishte për qëllim të krijonte bazën ligjore për modifikimin e skemës garantuese të FKGK-së, në mënyrë që të luftohej ngërçi kreditor që potencialisht do të mund të përkeqësonte edhe më tej efektet negative nga kriza ekonomike e shkaktuar nga pandemia.

Ligji i rimëkëmbjes ekonomike parashihte t'i mundësonte FKGK-së ofrimin e mbulueshmërisë së kredive për NMVM-të me garancion deri në 80%, lejimin e garancisë kreditore për fermerët dhe subvencionimin e tarifës së garancisë.

Zbatimi i kësaj iniciative të përbashkët u bë i mundur me kapitalin e siguruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Programit të Bankës Botërore për Fuqizimin e Sektorit Financiar si dhe nga Qeverisë Gjermane përmes Bankës Zhvillimore - KfW.

Në relacion me këtë, FKGK në fillim të vitit 2021 implementoi dritaret garantuese në kuadër të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike (PRE) të cilat do të adresonin nevojat për likuiditet dhe investime për sektorët dhe segmentet strategjike të vendit tonë.

FKGK përmes dritareve garantuese në kuadër të PRE-së, krahas skemës garantuese të kombinuar edhe me lehtësirën financiare siç ishte subvencionimi i tarifës së garancisë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, kishte për synim kthimin e konfidencës së sektorit financiar, si dhe evitimin e ngërçit kreditor, për të mbështetur riorganizimin e ekonomisë (prodhimin, bujqësinë, shërbimet, gratë në biznes, startup-et), masë e nevojshme në një situatë krize, siç ishte kjo e shkaktuar nga pandemia Covid-19.

Implementimi i Dritareve në kuadër të PRE-së filloi në fillim të vitit 2021 dhe përfundoi më 31 dhjetor 2021, ashtu siç parashihej në Ligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike – COVID-19.

II. IMPLEMENTIMI I PROGRAMIT

Implementimi i Dritareve në kuadër të PRE-së përbëhet nga disa faza dhe aktivitete.



ASPEKTI LIGJOR

Në aspektin ligjor, implementimi i Dritareve u mundësua krahas miratimit të Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike – COVID-19. Miratimi i Ligjit ishte i një rëndësie të veçantë për implementimin e programit të rimëkëmbjes ekonomike, që më pastaj do të sillte tejkalimin e krizës, ose zbutjen e pasojave nga kriza. Ligji mundësoi që FKGK të ofronte skemë garantuese me mbulueshmëri (garanci) më të lartë kreditore si dhe mbulim të tarifave nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që të dyja këto duke qenë masa të rëndësishme që të ktheheshin konfidenca në sektorin bankar, për të mbajtur aktiv kreditimin dhe për të parandaluar ngërçin kreditor që më pastaj do të sillte pasoja më të rënda për ekonominë.

Për më shumë ligji adresoi:

- Rritje të përqindjes së garancisë deri në 80%;
- Mundësinë e lëshimit të garancive kreditore për fermerët e regjistruar në mënyrë të rregullt në regjistrin e fermerëve, të cilët posedojnë Numër Identifikues të Fermës (NIF) edhe pse nuk kanë biznes të regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK);
- Subvencionimin e tarifës së garancisë nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

KAPITALI

Implementimi i Dritareve të PRE-së do të mundësohej përmes sigurimit të kapitalit, i cili u mundësua nga:

KAPITALI I DONUAR PËR PRE	€ 24,400,000
Qeveria e Republikës së Kosovës <i>Banka Botërore - Projekti për Fuqizimin e Sektorit Financiar në Kosovë</i>	€ 21,400,000
KFW	€ 5,000,000

Përpos kontributit në kapital, Qeveria e Republikës së Kosovës (QRK) përmes Ministrisë së Financave (MF) zgjeroi kontributin tutje, duke nënshkruar me FKGK-në marrëveshjen e bashkëpunimit për subvencionimin e tarifës së garancisë. Përmes kësaj marrëveshjeje, MF-ja u zotua të mbulojë

tarifën e garancisë në vlerë totale deri në 5 milionë euro, me ç'rast FKGK do të përdorte mjetet e disbursuara nga Qeveria për të mbuluar tarifën e garancisë për kreditë e garantuara në kuadër të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike.

PËRGADITJET OPERACIONALE

Për të adresuar kërkesën për mbështetje financiare të NMVM-ve të ndikuara nga kriza e shkaktuar nga COVID-19, FKGK dizajnoi dhe implementoi gjashtë dritare:

- Dritaren për prodhimin;
- Dritaren për bujqësinë;
- Dritaren për shërbimet (me fokus të veçantë në HORECA);
- Dritaren për tregtinë (në masë të kufizuar);
- Dritaren për gratë në biznes dhe
- Dritaren për bizneset e reja (start-up).

Dritaret e dizajnuara kishin karakteristika që i diferencionin nga dritaret aktuale, siç janë:

- Rritja e mbulueshmërinë me garancion kreditor deri në 80% të vlerës së kredisë;
- Përfshirja e fermerëve me Numër Identifikues të Fermerit (NIF);
- Rritja e ekspozimit garantues për sektorin e prodhimit deri në 500,000 euro nga standardja e cila është deri në 250,000 euro;
- Rritja e ekspozimit kreditor në mbi 1,000,000 EUR;
- Tarifa e garancisë – e subvencionuar nga QRK (deri në 5.0 mil. EUR).

Në relacion me këtë, FKGK hartoi Marrëveshjet e Garancisë për të cilat u dakorduan edhe Institucionet e Regjistruara Financiare (IRF). Po ashtu, bëri ndryshimet e nevojshme në politikën e riskut kreditor, në sistemet MIS dhe NAV dhe bëri ndarjet e limiteve për IRF-të.

Në përputhje me përpjekjet tona institucionale për të kontribuar në zhvillimin ekonomik me përgjegjësi të plotë për mjedisin dhe shoqërinë, duke siguruar që kreditë e garantuara t'i nënshtrohen kontrollit mjedisor, FKGK bëri përpjekjet maksimale që implementimin e Dritareve në kuadër të PRE-së ta bënte në përputhje me kërkesat e Sistemit të Menaxhimit Mjedor dhe Social (SMMS).

Për të arritur këtë qëllim, FKGK së bashku me Grupin e Bankës Botërore kanë hartuar SMMS-në për IRF-të që nuk kishin SMMS më parë, kanë ofruar mbështetje si dhe trajnime të duhura për personelin relevant në mënyrë që IRF-të sa më lehtë të implementojnë SMMS-në si dhe sa më lehtë të identifikojnë dhe t'i vlerësojnë ndikimet mjedisore e sociale para se të fillonte investimi.

Në mënyrë që të përçohet mesazhi te personeli i IRF-ve, ashtu që Dritaret e PRE-së të implementoheshin me lehtësi, FKGK organizoi një varg sesionesh orientuese në të cilat u diskutua për rëndësinë e skemave garantuese, sidomos në situata krizash, për adresimin që bëri QRK dhe donatorët ndërkombëtarë lidhur me këtë krizë, si dhe karakteristikat e dritareve të PRE-së.

Numri i personelit të IRF-ve që vijuan këto sesione orientuese së bashku me trajnimet për SMMS ishte gjithsej 1,057.

KOMUNIKIMI

Implementimi i Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike u shoqërua me një plan të komunikimit të përbërë nga një varg aktivitete, në mënyrë që të dërgohet informata tek personeli i IRF-ve, përfituesi final dhe publiku. Aktivitetet kishin karakter njoftues dhe të ngritjes së vetëdijes lidhur me risinë dhe përcjelljen e mesazhit mbi rolin e FKGK-së në implementimin e PRE-së si dhe mbështetjen e saj nga QRK dhe donatorët ndërkombëtarë.

Grupet e targetuara ishin:


- Institucionet Financiare;
- Sektori Privat i Biznesit dhe shoqatat relevante;
- Publiku i përgjithshëm.

Komunikimi u mbështet me lajme të transmetuara në media (TV, portale, shtyp, faqe të internetit të FKGK-së dhe mediat sociale) intervista ekskluzive me ekspertët e FKGK-së, mbajtje të tryezave të rrumbullakëta të palëve të interesit dhe forma të tjera informimi, duke përfshirë mediat sociale.


FKGK zhvilloi dhe shpërndau materiale të ndryshme informative si botime (revistë), broshura informative, pyetjet më të shpeshta (FAQ), dhe mori pjesë në intervista në media të ndryshme.

Njëkohësisht, në faqen e internetit të FKGK-së u shtua vegëza e veçantë për Rimëkëmbjen Ekonomike, ku u përfshinë dritaret dhe iniciativat e FKGK-së bashkë me donatorët për këtë çështje, me të gjitha informatat e nevojshme.

Për të mbajtur publikun të informuar rreth zhvillimit të këtyre Dritareve, FKGK në baza mujore informoi IRF-të, Donatorët dhe publikun lidhur me zhvillimin e portofolios së garantuar në kuadër të PRE-së.



III. TË ARRITURAT




Me kapitalizimin e institucionit, FKGK alokoi limite për tetë Institucione të Regjistruara Financiare gradualisht në katër faza, në vlerë prej gjithsej 83.9 milionë euro. Një alokim i tillë mundësoi një

kredidhënie në vlerë prej 105.55 milionë euro për NMVM-të e angazhuara në sektorët e Prodhimit, Shërbimeve, Bujqësisë, Tregtisë si dhe segmentet si Gratë në Biznes dhe Startup-et.

ZHVILLIMI I PORTOFOLIT TË DRITAREVE TË PRE-SË

Përkundër rritjes së perceptimit të riskut në treg dhe paparashikueshmërisë së rrjedhës së ngjarjeve të shaktuara nga gjendja që solli pandemia, FKGK në sajë të ndërmjetësimit përmes Dritareve të PRE-


së, gjatë 2021 mundësoi një huadhënie në sektor me vlerë prej 105.55 milionë eurosh, të shpërndara në 2,015 kredi për 1,720 NMVM, të mbështetura me garanci në vlerë prej 74.94 milionë eurosh.



GARANCITË KREDITORE SIPAS DRITAREVE GARANTUESE

Stimulimi i sektorëve që krijojnë vlerë të shtuar për ekonominë ishte një ndër objektivat e FKGK-së. Për këtë qëllim, FKGK me ndihmën e donatorëve dhe partnerëve të saj ka punuar në vazhdimësi në ndërtimin e dritareve të cilat do të mbështetnin

Rimëkëmbjen Ekonomike, me fokus të veçantë drejt forcimit të sektorëve strategjikë dhe segmenteve të marginalizuara siç janë gratë në biznes dhe startup-ët.




Dritaret e garancisë në kuadër të Pakos të Rimëkëmbjes Ekonomike ndikuan pozitivisht në rritjen e besimit të sektorit bankar, në drejtim të rritjes së aktivitetit kreditues pas krizës pandemike. Në mesin e 2,015 kredive për 1,720 NMVM, Dritarja më dominuese e me këtë edhe sektori më dominues në portofolin e kredive të garantuara gjatë vitit 2021-ës në kuadër të Dritareve të

PRE-së ishte Dritarja e shërbimeve me 29% e përcjellë nga Dritarja e tregtisë me 28% dhe Dritarja e prodhimit me 20%, ndërsa Dritarja e Bujqësisë kishte një pjesëmarrje prej 8%. Dritarja e grave në biznes kishte një pjesëmarrje prej 13%, e cila krahasuar me pjesëmarrjen e grave në biznes në gjithsej kreditë e garantuara gjatë vitit 2021, ishte më e lartë për 8.5%.

PJESËMARRJA E KREDIVE TË GARANTUARA SIPAS INVESTIMIT

Kërkesa për kredi dhe lloji i investimit na ndihmojnë të kuptojmë zhvillimet ekonomike gjatë periudhës së pandemisë. Në vitin 2021, në kuadër të Dritareve të PRE-së, 27% e kredive të aprovuara ishin investuar në pajisje (makineri të prodhimit, pajisje bujqësore, pajisje të tjera); 17% në tokë, në ndërtim ose në rinovim; 54% për kapital qarkullues dhe 3% në të tjera.

Nga këto të dhëna vërejmë se kreditë me destinacion për mall dhe likuiditet ishin fokus i investimeve të NMVM-ve gjatë kësaj periudhe që ndërlidhet me presionin e fluksit të parasë gjatë vitit 2021 por pa lënë anash investimet kapitale (pajisje, rinovim, ndërtim dhe blerje e tokës) të cilat po ashtu ishin evidente gjatë vitit 2021.



IV. SHTUESHMËRIA

Pako e Rimëkëmbjes Ekonomike (Dritaret e PRE-së) siç u theksua edhe më lart pritej që të zvogëlonte ndikimin negativ të krizës pandemike në sektorin e NMVM-ve, si dhe të lehtësonte qasjen në financa për NMVM-të gjatë dhe pas krizës pandemike.

Për të vërejtur këtë impakt, FKGK ka analizuar treguesit e ndërlidhur me shtueshmërinë financiare duke reflektuar në të dhënat e siguruara nga Regjistri Kreditor i Kosovës dhe të dhënat e siguruara nga Sistemi për Menaxhimin e Informatave (SMI) të FKGK-së. Me këtë rast u analizuan dhe u krahasuan kreditë e lejuara në sektor gjatë 2021 me kreditë e lejuara në sektor, përkatësisht kreditë të garantuara nga FKGK në kuadër të Dritareve të PRE-së.

Rezultatet e monitorimit të këtyre treguesve na treguan se në saje të aktivitetit të FKGK-së në përgjithësi është rritur qasja në financa dhe janë relaksuar standardet e huadhënies.


Për më shumë, Dritaret garantuese në kuadër të PRE-së ndikuan në shtueshmëri financiare si në:

- Rritje të nivelit të kreditimit për përfituesit finalë;
- Rritje të mesatares së kredisë;
- Rritje të maturitetit të kredisë;
- Ulje të kërkesës për kolateral.

PJESËMARRJA E KREDIVE TË GARANTUARA NË SEKTORIN BANKAR

Kreditë e garantuara në kuadër të Dritareve të PRE-së kishin një pjesëmarrje të dukshme në raport me gjithsej kreditë e miratuara gjatë vitit 2021 (segmenti i klientëve nën 1.0 milionë euro) në sektorin bankar. Në kategorinë e kredive deri në 100,000 euro pjesëmarrja e Dritareve të PRE-së në gjithsej kredidhënien në sektorin bankar në po të njëjtën

kategori ishte 17% (në shumë), që tregon një pjesëmarrje të konsiderueshme në gjithsej kredidhënien e IRF-ve deri në 100,000 euro, duke konsideruar në këtë mënyrë që skema e garancisë kreditore e FKGK-së ka shtuar ndikim pozitiv në ndërmjetësimin financiar.




SHUMA MESATARE E KREDIVE TË GARANTUARA

Portofoli i FK GK-së në kuadër të PRE-së në fund të viti 2021 ishte i populluar nga ndërmarrje të financuara me vlerë kreditore mesatare prej 52,000 eurosh. Kjo vlerë përputhet me kategorinë e vogël të ndërmarrjeve të cilat kanë mungesë kolaterali, andaj edhe nevojë për mbështetje financiare.

Kreditë e garantuara nga FK GK në kuadër të Dritareve të PRE-së në krahasim me kreditë e pagantuara në sektor deri në 100,000 euro, ishin për 33% më të larta.

Ngritja e shumës mesatare të kredisë përmes ndërmjetësimit të FK GK për këtë kategori e pasqyron ndikimin e skemës së garancive në standarde më të mira të kredihënies nga ana e bankave gjatë procesit të aprovimit të kredisë.




MESATARJA E MATURITETIT TË KREDISË

Portofoli i garantuar në kuadër të Dritareve të PRE-së gjatë viti 2021 përbëhej nga kredi afatmesme me një mesatare prej 38 muajsh. Mesatarja e maturitetit të kredisë, si tregues i shtueshmërisë financiare, në këtë vit tregoi rritje të maturitetit të kredisë të garantuara krahasuar me kreditë e pagantuara. Sa më i gjatë maturiteti, aq më të mira do të jenë kushtet e financimit për huamarrësit, ndërsa risku për huadhënësit do të jetë më i lartë.

Kohëzgjatja mesatare e kredisë të garantuara në kuadër të Dritareve të PRE-së deri në 100,000

euro ishte 37 muaj ose për 23% më e madhe se mesatarja e kredisë të pagantuara.

Krahas mundësive të ofruara nga Dritaret e PRE-së, ky tregues gjatë viti 2021 rezulton në standarde më të relaksuara të riskut nga ana e IRF-ve, ndaj edhe në kushte më të mira të huamarrjes për NMVM-të, të cilave çdo rritje e maturitetit ua rrit kapacitetin e huamarrësit për ta kompletuar investimin e planifikuar.




MBULUESHMËRIA ME KOLATERAL

Në periudhë pandemie, kur edhe pritshmëritë e riskut janë më të mëdha, IRF-të zvogëluar kërkesën për kolateral, krahas mundësisë së ofruar nga FKGK në kuadër të Dritareve të PRE-së, të cilat ofronin normë të garancisë deri në 80%.


Ndërkohë që kërkesat standarde të IRF-ve për kolateral janë mbi 150% të vlerës së kredisë, ku në mesin e kolateralit hyjnë edhe pasuritë e

patundshme, kreditë e garantuara në kuadër të Dritareve të PRE-së dukshëm kishin zvogëluar kërkesën për kolateral. 31% të kredive nuk ishin fare të kolateralizuara, ndërsa në tërësi për 64% të rasteve u kërkuar më pak se 100% kolateral. Po ashtu, po të konsiderohet që si kolateral shpesh merret malli, si dhe pengu i rendit të dytë ose edhe më shumë, atëherë mund të themi që impakti i Dritareve të PRE është akoma më i lartë.



NUMRI I PARASHIKUAR I VENDEVE TË KRIJUARA TË PUNËS

Investimet e realizuara nga kredia përmes mbështetjes së skemës së garancisë kreditore në rrethanat më të mira do të pasqyroheshin me vende të reja pune, të krijuara në sektorin privat.



Nëse analizojmë 2,015 kreditë e miratuara dhe të garantuara brenda Dritareve të PRE-së gjatë 2021, vërejmë se NMVM-të kanë parashikuar 3,645¹ vende të reja pune ose rritje prej 23% mbi bazën aktuale.

1 Numri i vendeve të reja llogaritet nga të dhënat e procesuara në Sistemin e Menaxhimit Informativ të FKGK-së, me çrast IRF-të procesojnë të dhënat e deklaruara nga NMVM-të.

Indikatorët e paraqitur janë rezultat i të dhënave kuantitative të siguruara nga RKK* dhe SIM i FKGGK-së, përderisa konsulentët të Bankës Botërore janë angazhuar për të bërë një studim të thukët duke kombinuar intervistat më përfaqësues të IRF-ve dhe të institucioneve relevante, të dhënat kuantitative dhe kualitative, si dhe duke bërë një krahasim të klientëve të të njejtit profil (të garantuar dhe të paguarantuar). Ky studim, i cili pritet të përfundojë në kuartalin e parë të 2021, do të na ofrojë një pasqyrë më të qartë për impaktin e

Dritareve të PRE-së. Për më tej, ky studim do të na japë përgjigje më të saktë nëse:

- Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike (Dritaret e PRE-së) ka zbutur ndikimin negativ të krizës pandemike në sektorin e SME-ve, si dhe nëse
- Dritaret e PRE-së kanë lehtësuar qasjen në financa për NMVM-të gjatë dhe pas krizës pandemike.

* Të dhënat në raport janë sipas raportimit të bërë deri më 20.01.2022. Çdo përditësim i tyre mund të ndryshojë ndonjë informatë!

PËRSHTYPJET NGA SEKTORI FINANCIAR

Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike është vlerësuar nga Institucionet e Regjistruara Financiare (IRF) të cilat që në fillim e pranuan si një rrugë të domosdoshme për mbështetjen e qasjes në financa, duke përfshirë të gjithë sektorët dhe kategoritë e klientëve të ndikuar nga kriza.

Sipas IRF-ve, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në rimëkëmbjen ekonomike nga pasojat e pandemisë. Sektori bankar ka gjetur një mbështetje të çmuar

në çdo hap të këtij rrugëtimi jo të lehtë në vitin që lamë pas. Përmes skemave garantuese që FKGGK ka vënë në dispozicionin e sektorit, sektori bankar ka arritur të kreditojë segmente të ndieshme të ekonomisë, të cilat kanë pasur nevojë për likuiditet dhe investime dhe të cilat pa mbështetjen e Fondit do të kishin qasje më të vështirë në financa. Në veçanti vlen të ceket se është shënuar progres në kreditim në sektorin e prodhimit, të shërbimeve dhe të grave në biznes, si kategori të rëndësishme për ekonominë e vendit.



V. STORIE SUKSESI NGA PËRFITUESIT PËRFUNDIMTARË

Për të vizualizuar ose prekur realitetin, në vazhdim ju njoftojmë me disa klientë përfitues të Dritareve në kuadër të PRE-së, disa storie suksesi të cilat paraqesin përfitimet që kjo skemë u solli në praktikë NMVM-ve.



“THE WHITE TREE” – Një start up në lagjen Pejton

“The White Tree” - është një restorant në Prishtinë, i themeluar në vitin 2020 nga tre shokë/kolegë të mëhershëm.

“Të themelosh një biznes që prej fillimit është sfidë, ndaj përpos aspektit financiar futja në një aktivitet të ri është më e lehtë kur nuk i hyn i vetëm, por së bashku me partnerë. Ne filluam biznesin në vitin 2020 mu në fillim të pandemisë. Ishte iniciativë e përbashket e partnerëve për të sjellë një koncept të ri, me një shërbim cilësor në lagjen ku operojmë”, thekson z. Durim Xhiha, bashkë-pronar dhe drejtor i biznesit ‘White Tree’.

‘White Tree’ punëson 19 punëtorë, ndërsa aktualisht është në proces të zgjerimit edhe me 6 punëtorë shtesë. Fuqizimi i gruas është njëri nga synimet e themeluesve, ndaj është planifikuar që pjesëmarrja e grave, nga 40% sa është aktualisht, të rritet për të arritur në 60%.

“Investimet në biznes kryesisht u bënë nga kapitali i bashkëthemeluesve, por gjithsesi kishte nevojë për një injektim shtesë, për të përfunduar investimet në inventarin e restorantit. Këtë investim e arritëm me kredinë e garantuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore”, thekson z. Xhiha.

Përmes investimit të bërë, biznesi arriti të funksionalizojë hapësirën e restorantit, duke e bërë të gatshme për fillimin e aktivitetit.

Mbështetja e këtij investimi është bërë përmes kredisë së garantuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, së bashku me Programin COSME të Fondit Europian për Investime, të cilat janë duke mbështetur qasjen në financa për NMVM-të në fazat e ndryshme të ciklit, si gjatë krijimit, zgjerimit apo transferimit të biznesit.



MOEA – FRUTOMANIA - Shishe e vogël me dashuri të madhe!

Gjithnjë është kënaqësi kur shkon dhe e viziton një biznes vendor, i cili me tërë kapacitetin përkujdeset të ofrojë produkte cilësore dhe krejt natyrale.

Fabrika të cilën e vizituam, është themeluar që në vitin 2006. Qysh atëherë ideja dhe qëllimi kryesor kanë qenë dhe mbeten kultivimi, prodhimi dhe plasimi në treg i produkteve natyrale të të gjitha llojeve të pemëve që kultivohen në tokën e Kosovës.

Natyra që e rrethon fabrikën, mjetet, hapësira, kushtet e punës, organizimi i gjithëmbarshtëm, të lënë përshtypjet më të bukura dhe një mësim se si duhet të funksionojë e të rritet prodhimtaria.

Fshati Kravaricë afër Gjilanit është pikërisht vendndodhja e biznesit që vizituam – MOEA – i cili kultivon mollë, vishnje, boronicë dhe fruta të tjera me gjithë kapacitetin e vet.

Aty prodhohen lëngje e reçelë FRUTOMANIA, që janë 100% natyralë dhe të llojllojshëm. Është një brend ky që ka emër për cilësi, ofron produkte të shëndetshme, origjinale dhe 100% natyrale.

Era e mollëve, ambienti i pastër, pjesa ku bëhet përzgjedhja e frutave, konzervimi, shtrydhja dhe i tërë zinxhiri i prodhimit të lëngjeve super-natyrale e

vendore, janë tregues që ky biznes është rritur dhe qëllim kryesor ka cilësinë dhe ofrimin e produkteve të shëndetshme.

Me mbi 400 hektarë tokë, mbi 30 punëtorë të rregullt gjatë gjithë vitit dhe të tjerë sezonalë, varësisht nga volumi i punës, MOEA ka arritur që me profesionalizëm e përkushtim, përveç tregut vendor të depërtojë edhe në atë ndërkombëtar, sepse cilësia është kriteri kryesor për këtë biznes. Deri sot ka arritur të plasojë 16 lloje të pijeve të ndryshme, natyrale dhe shumë cilësore, reçelë dhe pije alkoolike në shumë vende europiane si Austri, Hungari, Finlandë, Itali, natyrisht edhe në Shqipëri.

MOEA është biznes që ka shfrytëzuar kredinë nga skema garantuese e FKGK-së, në kuadër të PAKOS SË RIMËKËMBJES EKONOMIKE. Në fakt, janë dy kredi të shfrytëzuara, e të cilat kryesisht janë përdorë për sigurimin dhe furnizimin me lëndë të parë, repromaterial dhe ambalazhim. Këto kredi janë aprovuar shpejt dhe lehtë, pa pasur nevojë për kolateral, si pjesë e lehtësimit të qasjes në financa që ka ofruar pakoja e rimëkëmbjes.

Mikpritja, prezantimi profesional i biznesit nga stafi dhe menaxhmenti që takuam, na la shije të mirë të një biznesi vendor që vazhdon të zhvillohet dhe t'i rrisë kapacitetet e veta.



AGRIUM FRUITS SHPK - Storje e veçantë suksesi

Në një ditë të bukur shtatori shkuaam për vizitë në kompaninë AGRIUM FRUITS SHPK, që ndodhet në fshatin Lloshkobar në afërsi të qytetit të Ferizajit, ku takuam një ndërmarrës të veçantë, zotërinë Avdullah Isufi. Ishte burrë punëtor, modest, mikpritës, i cili që në takimin e parë të mahniste me profesionalizmin dhe njohuritë e informatat që lidhen me agrobiznesin.

Me të hyrë në oborrin e tij, ku kishte edhe shtëpinë edhe biznesin, shihej një kopsht i rregulluar për bukuri me lule plot ngjyra. Nga gjithë rendi e pastërtia shihej përkushtimi ndaj punës dhe biznesit të tij.

Këtë biznes e themeloi në vitet 2000, e tanimë punët kyçe ua ka besuar djemve të vet. Filloi njëherë me prodhimtari primare, pastaj gjithnjë e zgjeroi punën dhe aktivitetet që ndërlidhen me mbledhjen dhe konzervimin e frutave dhe perimeve të freskëta e cilësore nga fermerët dhe gjetjen e tregjeve, si dhe sigurimin e inpueteve të ndryshme bujqësore.

Vitet 2010-2011 ishin vendimtare për rritjen dhe zgjerimin e biznesit të tij. Në vitin 2016, përmes kredive, AGRIUM FRUITS SHPK kishte siguruar blerjen e frigoriferëve në mënyrë që të rritë kapacitetin e grumbullimit, selektimit, paketimit dhe eksportit në BE. Viti 2016, konkretisht muaji shtator, lidhet edhe me kohën kur u operacionalizua Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK). Ndër garancitë e para kreditore të lëshuara ishte ajo për

kompaninë AGRIUM FRUITS SHPK, pikërisht për këtë investim.

“Me zgjerimin e vazhdueshëm të aktiviteteve, ne kishim nevojë për investime në pajisje në mënyrë që aktiviteti ynë të mbështetej sa më mirë. Këtë investim e arritëm me kredinë që u garantua nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, krahas të cilës edhe kërkesa për kolateral ishte shumë më e ulët”, thekson z. Isufi.

Duke qenë klient me histori kreditore të shkëlqyeshme, përsëri kishte shfrytëzuar kredi tjetër, të garantuar nga FKGK, për të blerë kësaj radhe pajisjet për selektim të rendimenteve (shiritë dhe detektorë që në mënyrë automatike bëjnë përzgjedhjen e rendimentit).

“Kosova ka kapacite të mëdha për të prodhuar llojlloj kulturash bujqësore për plotësimin e nevojave të tregut të mbrendshëm dhe për eksport. Vetëm na duhet angazhim, përkushtim dhe punë shumë e madhe”, janë fjalët që ky njeri i urtë e punëtor na tha ditën që e vizituam. “Përmes kredive, shumë biznese kanë mundësinë të zhvillohen dhe të rriten ashtu si kam bërë unë”.

Duke na treguar edhe punëtorinë dhe pjesën e investimeve që kishte bërë në shumë pajisje, u ndamë me përshtypjet më të mira për një biznes që është rritur në Kosovë.



NATYRA G - Shtëpia e djathit

Nga Prishtina, nëpër rrugën e vjetër, jo shumë larg hyrjes në Ferizaj, në vendin e quajtur Prelez i Muhaxherëve, në mesin e shumë bizneseve ndodhet edhe ai që e vizituar – shtëpia e djathit NATYRA-G.

Një zonjë e buzëqeshur plot energji, Shemsija na pret në vendpunimin, të cilin ajo së bashku me bashkëshortin, Idrizin, e filluan në vitin 2011. Fabrika e prodhimeve të qumështit natyral, ka edhe llojllojshmëri produktesh të tjera si: djath, kaçkavall, xhizë, kos e jogurt, si dhe shumë lloje produktesh që shquhen për origjinalitet dhe janë krejt natyrale. Fabrikë me shumë makina të reja, ku përpunohen produktet e qumështit, paketohen dhe përgatiten për distribuim.

“Këtu gjithçka është BIO, sepse ky është koncepti i biznesit tonë qysh në fillim”, na thotë zonja Shemsija, një punëtore e madhe që me shumë mund e nisi dhe e ngriti këtë biznes.

“Gjithnjë kam ëndërruar që ta rris biznesin, që të kemi pajisje moderne dhe të sofistikuara që e lehtësojnë dhe mundësojnë prodhimin cilësor të produkteve natyrale.”

Tanimë kemi arritur t'i kemi pajisjet e dëshiruara, i kemi blerë përmes kredisë që e shfrytëzuam, e që na është garantuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore.

“Këtë kredi na kanë aprovuar shumë shpejt, pa kolateral dhe me procedura të shkurtuara. Si klientë që kemi paguar rregullisht këstet dhe kreditë, kishim përparësi dhe u kualifikuam që të investonim edhe më tutje në biznesin tonë”, na tha Shemsija.

“Tanimë kemi rritur kapacitetet dhe kemi mbi 20 punëtorë të rregullt. Sot punojmë me kapacitet përpunimi të 2500 litrave qumësht brenda ditës, edhe pse kemi mundësinë të shkojmë deri në 70 000 litra, gjë që kemi synim për të ardhmen”, na tha zoti Idrizi, burrë që gjithmonë i rri krah Shemsijes, e cila shquhet për organizim dhe për kryerjen e të gjitha punëve operative që kërkon ky biznes.

Natyrë G, aty ku është e angazhuar gjithë familja, ka ndërtuar dhe ngritur fabrikën vit pas viti duke investuar dhe rritur kapacitetet prodhuese nga qumështi krejtësisht natyral.



Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

Adresa:
Njazi Alishani Nr. 5,
10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 (0) 38 225 600
info@fondikgk.org

www.fondikgk.org